



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 10 DATË 16/03/2021

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK URA VAJGURE NR 70 DATË 02/12/2020 'Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Urë Vajgurore'.

Këshilli Bashkiak Urë Vajgurore, në mbledhjen e tij të datës 16/03/2021, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore', Neni 54, Neni 55, të Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006 'Për sistemin e taksave vendore', i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 70 datë 02/12/2020 'Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Urë Vajgurore', shkresës së Prefektit të Qarkut Beratme Nr 1079/2Prot datë 17.12.2020 "Për verifikim të ligjshmërisë së akteve", shkresës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, me Nr 5/43 Prot datë 11.02.2021, të Ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhër Nr 633 Datë 17.11.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", Urdhër Nr 80 Datë 17.11.2020, Neni 6 pika 1, i DAP "Departamenti i Administratës Publike" Miratimin e rregullave dhe procedurave standarte të punës të harmonizuara, gjatë peirudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021

VENDOSI:

Me 21 vota PRO duke përdorur platformën e komunikimit, live/online Webex Meeting, ZOOM/WhatsApp të miratojë: 1. Të hiqet emërtesa "Përjashtohen nga pagesa e taksës së pasurisë "Taksapaguesit, për kategorinë I "Ndërtesa banimi" dhe që i përkasin kategorive me status "Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës" si dhe të sëmurë para dhe tetraplegjikë., në përcaktimin II, Taksa e ndërtesës, pika a, të vendimit të Këshillit Bashkiak nr 70 datë 02/12/2020 'Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Urë Vajgurore'.

Shënim ky vendim u miratua me 11 vota PRO duke përdorur platformën e komunikimit, live/online Webex Meeting, ZOOM dhe 10 vota PRO përdorur platformën e komunikimit, live/online WhatsApp.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



